PSH.nr.1088/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të Blerim Dina - Kryetar, Nuhi Paçarizi - Referues, Goran Milenkovic – Anëtarë, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: "Alfa.I" SH.P.K-Lipjan, kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit , lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Renovimi i ndërtesës për nevojat e qendrës për Ekselencë Digjitale" me nr. të prokurimit: 213-20-5340-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- "Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit", më datën: 11.01.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik "Alfa.I" SH.P.K-Lipjan, kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Renovimi i ndërtesës për nevojat e qendrës për Ekselencë Digjitale" me nr. të prokurimit: 213-20-5340-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- "Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit".

II. VËRTETOHET, njoftimi për anulim për aktivitetin e prokurimit me titull "Renovimi i ndërtesës për nevojat e qendrës për Ekselencë Digjitale" me nr. të prokurimit: 213-20-5340-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- "Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit".

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues "Alfa.I" SH.P.K-Lipjan, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Operatori ekonomik ankues "Alfa.I" SH.P.K-Lipjan, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 11.12.2020 me nr. 1088/20, kundër njoftimit për anulim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Renovimi i ndërtesës për nevojat e qendrës për Ekselencë Digjitale" me nr. të prokurimit: 213-20-5340-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- "Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit", duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 6, 7, 59, 60, 62 dhe 72 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, si dhe neni 44.5 të RRUOPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 16.12.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues-profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 26.12.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE ankues sqaron si në vijim:

Përgjigje në Pretendimi nr. 1

Operatori ekonomik ankues "ALFA.I" SH.P.K, pretendon se nuk qëndron vlerësimi i AK-së, sa i përket pikës 4 të kërkesës së dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë te Kapaciteti teknik dhe profesional. Eksperti shqyrtues konstaton se kërkesë e dosjes së tenderit dhe e njoftimit për kontratë tek kërkesa nr. 4 është kërkuar: Një (1) Inxhinier në Menaxhimin e emergjencave – mini. 3 vite përvojë pune pas diplomimit", si dëshmi dokumentare është kërkuar: "Diploma e noterizuar nga vetë Inxhinieri nga origjinali, CV e nënshkruara nga inxhinieri, kontrata ose marrëveshja e punës për këtë projekt valide me punëdhënësin, titulli i projekti, vlera e projekti , vendi i ekzekutimit të projektit". Duke pasur parasysh kërkesën e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë, eksperti shqyrtues sqaron se kjo kërkesë e dosjes së tenderit është plotësuar nga OE ankues sepse si Inxhinier në Menaxhimin e emergjencave, e ka ofruar z. Ardian (Ismet) Haxhiu, për më tepër ju ofrojmë dëshmitë:



REPUBLIKA E KOSOVËS
NOTER

Pengrami Menaxhimit i Shëndetësisë

DIPLOMË

ARDIAN ISMET HAXHIU

MASTER I ARTEVE NË MENAXHIMIN E EMERGJENCAVE

CV

1. Pozicioni i Propozuar: Inxhinier në menaxhimin e emergjencave
2. Kompania: Alfa.i
3. Emri:Ardian
4. Mbiemri: Haxhiu
5. Data e lindjës:31.07.1986
6. Shtetësia:Kosovar
7. Statuti Civil:E martuar
8. Edukimi:Superior

Institucioni (Emri, qyteti,shteti)	Data (muaji / Viti) Prej	Data (muaji / Viti) Deri	Fakulteti	Titulli
Koleggi Biznesi - Kosove	2012/2013	2015	Master - Menaxhimi i Emergjencave	Master i arteve në menaxhimin e emergjencave

9. Zotrimi i gjuhëve, nota nga 1 deri 5:

Gjuha	Lexim	Te folurit	Shkrimi
Gjuha shqipe-amtare	5	5	5
Gjuha angleze	4	4	4

10. Anëtar në ndonjë organ profesional:N/A

11. Shkathtësit tjera: MS Office, Përpilimi i raporteve per menaxhim te emergjencave etj.

12. Eksperienca:

Nr.	Emri i Projektit dhe Vendi i Investimit	Emri i kompanisë kontraktuese	Pozicioni ne kete projekt	Investitori, personi kontaktues dhe info(tel.ose mob.)	Filimi dhe Mbarimi i Projektit (Viti)
1	Projektimi dhe kryerja e puneve ne qendra e Riciklimit	ALFA.I SH.P.K	Inxhinier ne menaxhimi e emergjencave	KK Mitrovice	2018
2	Renovimi i 25 Objekteve	ALFA.I SH.P.K	Inxhinier ne menaxhimi e emergjencave	MZHE	2018
3	Ndertimi i shkolles se mesme ne Gracanice	ALFA.I SH.P.K	Inxhinier ne menaxhimi e emergjencave	EU	2017
4	Construction of Common Crossing Point in Mutivoda	ALFA.I SH.P.K	Inxhinier ne menaxhimi e emergjencave	EU	2017 - 2019
5	Renovimi i 14 Objekteve	ALFA.I SH.P.K	Inxhinier ne menaxhimi e emergjencave	MZHE	2016 - 2018
6	Ndertimi betonimi i kanalit te ujitjes ne Grabanice, Kline, Lot 1	ALFA.I SH.P.K	Inxhinier ne menaxhimi e emergjencave	MBPZHR	2015 - 2016
7	Implementation of Works in North Kosovo	ALFA.I SHPK	Inxhinier ne menaxhimi e emergjencave	EU	2015 - 2019

13. Te tjera:

Përgjigje në Pretendimi nr. 2

Eksperti shqyrtues konstaton se OE ankues "ALFA.I" SH.P.K, pretendon se nuk qëndron arsyetimi AK-së, sa i përket Inxhinieres së Arkitekturës, znj. Nafije Gashi, ku pretendohet nuk është certifikuar për softuerin iSBEM-XK. Eksperti shqyrtues konstaton se kërkesë e dosjes së tenderit dhe e njoftimit për kontratë tek kërkesa nr. 15 është kërkuar: "OE duhet të paraqes se ka ne dispozicion një Arkitekt të jete trajner për auditor të energjisë me standarde EN 16247 ose auditor i energjisë i certifikuar me standard EN 16247, te ketë provoj pune në efiçencë te energjisë se paku 5 vite, gjithë ashtu edhe i certifikuar për softuerin iSBEM-XK ne vlerësimin e përformances se energjisë ne ndërtesa", si dëshmi dokumentare është kërkuar: "Diploma dhe certifikatat e noterizuar nga vete arkitekti nga origjinali, CV e nënshkruara nga inxhinieri, kontrata ose marrëveshja e punës për këtë projekt valide me punëdhënësin, titulli i projekti, vlera e projekti, vendimi i ekzekutimit të projektit". Duke pasur parasysh kërkesën e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë, eksperti shqyrtues sqaron se kjo kërkesë e dosjes së tenderit, mendoj se nuk është plotësuar nga OE ankues sepse për Inxhinieren e Arkitekturës, znj. Nafije Gashi, nuk janë ofruar dëshmi se e njëjta është e certifikuar për softuerin iSBEM-XK, shih dëshmitë:

German cooperation

giz

CERTIFICATE

Nafije Gashi

completed with success the Training of Trainers course for

Energy Auditing in Buildings

in Prishtina in the period from 12th October until 9th November 2018.

The course comprised the lectures, on-site auditing with preparation of energy audit report and the exam, based on standard EN 16247.

The course is financed by the German Government, implemented by Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

within

KEEP – Kosovo Energy Efficiency Project supporting the Ministry of Economic Development

Held by the consortium of:

ENERGY INSTITUTE HRVOJE POŽAR, Croatia

and

FIRE - FEDERAZIONE ITALIANA PER L'USO RAZIONALE DELL'ENERGIA, Italy

Course leader: Ivan Bolanca, Ph.D.

On behalf of EIHP & FIRE consortium

Prishtina, 9th November 2018

EIHP

CERTIFICATE

No. EKAS-2015-014

on proficiency in using nationally approved software iSBEM-XK for preparation of Energy Performance Certificates

given to

Nafije Gashi

in Prishtina on August 15, 2019

This certificate was issued based on 20 days training course held in Prishtina, Kosovo, in July 1-5 and July 15-26, 2019 and on successfully passing of related exam.

The training course and related exam were conducted by

EU funded project

Support on implementing the 3rd Energy Package with focus on Energy Efficiency and Renewables

in cooperation with

Building Research Establishment Limited (BRE)

EU funded project

Zoran Morvaj, Team Leader

BRE

Paul Goodman, Technical Director

Training of Energy Advisors in Kosovo implemented by Application of Energy Performance Certificates and operation and training of Energy Advisors

Përgjigje në Pretendimi nr. 3

Eksperti shqyrtues konstaton se OE ankues "ALFA.I" SH.P.K, pretenndon se AK-së, konform nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së, ka mundur të kërkojë sqarime shtesë, për inxhinierin e kërkuar.

Eksperti shqyrtues konstaton se kërkesë e dosjes së tenderit dhe e njoftimit për kontratë tek kërkesa nr. 16 është kërkuar: "OE duhet të paraqes se ka ne dispozicion Një Inxhinier i elektroteknikes te jete trajner për

auditor te energjisë me standarde EN 16247 ose auditor i energjisë i certifikuar me standard EN 16247, te këtë provoj pune ne efiçencë te energjisë se paku 5 vite, gjithë ashtu edhe i certifikuar për softuerin iSBEM-XK ne vlerësimin e performancës se energjisë ne ndërtesa", si dëshmi dokumentare është kërkuar: "Diploma dhe certifikatat e noterizuar nga vete arkitekti nga origjinali, CV e nënshkruara nga inxhinieri, kontrata ose marrëveshja e punës për këtë projekt valide me punëdhënësin, titulli i projekti, vlera e projekti , vendimi i ekzekutimit të projektit". Duke pasur parasysh kërkesën e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë, eksperti shqyrtues sqaron për Inxhinier i elektroteknikes, të prezantuar në Listën e stafit Profesional, z. Petrit Krasniqi, në dosjen e tenderit nuk ka ofruar dëshmi fare. Dëshmitë për këtë inxhinier i ka bashkangjitur me ankesë, shih dëshmitë:



European Union Kosovo

Implementing the 3rd Energy Package with focus on Energy Efficiency and Renewables

In cooperation with bre

CERTIFICATE

No. ENAS-2019-015

on proficiency in using nationally approved software ISBEMxk for preparation of Energy Performance Certificates

given to

Petrit Krasniqi

in Pristina on August 15, 2019

This certificate was issued based on 10-days training course (held in Pristina, Kosovo, in July 1-5 and July 15-19, 2019) and on successfully passing of related exam.

The training course and related exam were conduced by

EU funded project
Support on Implementing the 3rd Energy Package with focus on Energy Efficiency and Renewables

in cooperation with

Building Research Establishment Limited (BRE)

EU funded project
Zoran Morvaj, Team Leader

BRE
Paul Davidson, Technical Director

Training of Energy Assessors in Kosovo is regulated by legislation on Energy Performance Certification and legislation on training and licensing of Energy Assessors

Përgjigje në Pretendimi nr. 4

Eksperti shqyrtues konstaton se OE ankues "ALFA.I" SH.P.K, pretenndon se në dosjen e tenderit janë ofruar dokumentet gabim, pra janë ofruar dokumentet e Ramadan Gashit, dhe AK-së nuk i ka marrë parasysh fare sqarimet tona. Eksperti shqyrtues konstaton se kërkesë e dosjes së tenderit dhe e njoftimit për kontratë tek kërkesa nr. 18 është kërkuar: OE duhet të paraqes se ka ne dispozicion Një Inxhinier i makinerisë te jete trajner për auditor te energjisë me standarde EN 16247 ose Auditor i Energjisë i certifikuar me standard EN 16247, te këtë provoj pune menaxherja ne efiçencë te energjisë se paku 5 vite, gjithë ashtu edhe i certifikuar për softuerin

i SBEM-XK në vlerësimin e performances se energjisë ne ndërtesa. Duke pasur parasysh kërkesën e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë, eksperti shqyrtues sqaron se për Inxhinier i makinerisë, z. Sherif (Ramadan) Gashi, në dosjen e tenderit nuk ka ofruar dëshmi fare, mirëpo dëshmitë e ka ofruar të bashkangjitura me ankesë, shih dëshmitë:

Universiteti i Prishtinës
University of Prishtina

FAKULTETI I MAKINERISË

DIPLOMË

E KUALIFIKIMIT UNIVERSITAR

SHERIF RAMADAN GASHI

LINDUR NË STUDENÇAN-SUHAREKË MË 1 PRILL 1956
REGJISTRUAR NË VITIN AKADEMIK 1976/77
MË 9. 7. 1986 I KA DHËNË PROVIMET E PARAPARA
PËR TË MBARUAR FAKULTETIN E MAKINERISË
DREJTIMI MAKINERIA PRODHUESE
DHE ME KËTË MËRR KUALIFIKIMIN

INXHINIER I DIPLOMUAR I MAKINERISË

Nota mesatare gjatë studimeve 6.67
Nota e provimit të diplomës 9.00

PRISHTINË, MË 23 NËNTOR 2005, NR. 203

Dekani Prof. Dr. Jahi Hoxha

CERTIFICATE OF TRAINING

Certificate No. AOS/T/STS/102020

Name Surname **Ing. SHERIF GASHI**

Date of Birthday 02-04-1956

Education FAKULTETI OF MECHANICAL ENGINEERING, Number of degree 203, Date 23-11-2005

Completed the training
"EN 16247- "Energy Auditing in Buildings (including Public Lighting)"

Topics covered:

- Regulatory framework related to energy audits and applicable standards in the EU;
- Laws and regulations related to energy auditing;
- Energy auditing basics;
- Economic calculations in energy auditing;
- Building physics;
- Building constructions;
- Building heating systems;
- Building cooling, ventilation and air-conditioning systems;
- Electric lighting and other electric systems in buildings;
- Methodology for calculating energy performance of buildings;
- Public lighting;
- Methodology for conducting energy audits;
- Overview of characteristic measurements in buildings.

Training dates 25/08/2020 26/08/2020 Hours 40
Place of training Tirana, Albania
Training organizers AOSCERT shpk "Conformity Assessment Body"

Date of issue 26/08/2020 The expiry date 26/08/2023

The validity of the certificate can be checked at http://aoscert.org/en/online-aos-form following the instructions that are reflected there

AOSCERT

For certification body

Çertifikatë/Certificate

Konfirmon se

SHERIF GASHI

ka kryer me sukses

Trajnimin për Përdorimin e Software-it: ISBEMxk
(24-28 Shtator 2020)

Besnik KRASNIQI
Director
Business Support Centre
Kosovo

BUSINESS SUPPORT CENTRE KOSOVO BSC KOSOVO PRISHTINE

Prishtinë, Shtator 2020

Përgjigje në Pretendimi nr. 5

Eksperti shqyrtues konstaton se OE ankues "ALFA.I" SH.P.K, pretendon se nuk qëndron pretendimi i AK-së, se nuk janë plotësuar kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë sa i përket pikave 5, 6, 88, 12, 13 dhe 14, sepse siç shihet ka qenë i autorizuar nga ana jonë z.Lulzim Jahaj, që të bëjë Noterizimin e dokumenteve Eksperti shqyrtues konstaton se kërkesë e dosjes së tenderit dhe e njoftimit për kontratë tek kërkesat me nr. 5 , 6, 8, 12, 13 dhe 14, është kërkuar që Diplomat dhe Certifikatat të Noterizohen nga vetë Inxhinierët dhe Ekspertët.

Eksperti shqyrtues sqaron se pas analizimit të arsyes së eliminimit të AK-së, si dhe pas analizimit të dëshmive të ofruara nga OE ankues, mund të konkludojmë se Dokumentet e kërkuara si Diplomat apo Certifikatat janë dërguar për noterizim tek Noteri nga z. Lulzim Jahaj, ashtu si e ka deklaruar edhe vet OE ankues.

Përgjigje në Pretendimi nr. 6

Eksperti shqyrtues konstaton se OE ankues "ALFA.I" SH.P.K, pretendon se projekti në fjalë është tërhequr nga Kodi Ekonomik, është i pa bazuar. Eksperti shqyrtues sqaron se në e-prokurim nuk kamë mundur të hasë ndonjë dokument ku dëshmon se ky projekt është hekur nga Buxheti si Kod ekonomik. Eksperti shqyrtues sqaron se kërkesë e dosjes së tenderit dhe e njoftimit për kontratë për Inxhinierët e kërkuar tek pikët 15, 16 dhe 18, si dëshmi janë kërkuar që të njëjtit të jenë të certifikuar për softuerin i SBEM-XK në vlerësimin e performances se energjisë në ndërtesa. Andaj nga dëshmitë e ofruara nga OE ankues në dosjen e tenderit dhe dëshmitë e ofruara së bashku me ankesë, mund të konkludojm se znj. Nafie Gashi dhe z. Petrit Krasniqi, NUK kanë dëshmi se të njëjtit janë të certifikuar për softuerin SBEM-XK në vlerësimin e performances se energjisë në ndërtesa, për më tepër shih Certifikatën e z. Sherif Gashi.

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, dhe të mbetët në fuqi vendimi për anulim të aktivitetit të prokurimit.

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 28.12.2020 me raportin e ekspertizës.

Autoriteti Kontraktues me datë: 28.12.2020 me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik "Alfa.I"SH.P.K-Lipjna me datë: 29.12.2020, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet pjesërisht me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 11.01.2021, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Operatori ekonomik ankues "ALFA.I" SH.P.K, pretendon se nuk qëndron vlerësimi i AK-së, sa i përket pikës 4 të kërkesës së dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë te Kapaciteti teknik dhe profesional. Eksperti shqyrtues konstaton se kërkesë e dosjes së tenderit dhe e njoftimit për kontratë tek kërkesa nr. 4 është kërkuar: Një (1) Inxhinier në Menaxhimin e emergjencave – mini. 3 vite përvojë pune pas diplomimit", si dëshmi dokumentare është kërkuar: "Diploma e noterizuar nga vetë Inxhinieri nga origjinali, CV e nënshkruara nga inxhinieri, kontrata ose marrëveshja e punës për këtë projekt valide me punëdhënësin, titulli i projekti, vlera e projekti , vendi i ekzekutimit të projektit".
Duke pasur parasysh kërkesën e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se kjo kërkesë e dosjes së tenderit është plotësuar nga OE ankues sepse si Inxhinier në Menaxhimin e emergjencave e ka ofruar z. Ardian (Ismet) Haxhiu.

OE ankues "ALFA.I" SH.P.K. pretendon se nuk qëndron arsyetimi AK-së, sa i përket Inxhinieres së Arkitekturës, znj. Nafije Gashi, ku pretendohet nuk është certifikuar për softuerin iSBEM-XK. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se kërkesë e dosjes së tenderit dhe e njoftimit për kontratë tek kërkesa nr. 15 është kërkuar: "OE duhet të paraqes se ka ne dispozicion një Arkitekt të jete trajner për auditor të energjisë me standarde EN 16247 ose auditor i energjisë i certifikuar me standard EN 16247, te ketë provoj pune në efiçencë te energjisë se paku 5 vite, gjithë ashtu edhe i certifikuar për softuerin iSBEM-XK ne vlerësimin e përformances se energjisë ne ndërtesa", si dëshmi dokumentare është kërkuar: "Diploma dhe certifikatat e noterizuar nga vete arkitekti nga origjinali, CV e nënshkruara nga inxhinieri, kontrata ose marrëveshja e punës për këtë projekt valide me punëdhënësin, titulli i projekti, vlera e projekti, vendimi i ekzekutimit të projektit".
Duke pasur parasysh kërkesën e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se kjo kërkesë e dosjes së tenderit nuk është plotësuar nga OE ankues sepse për Inxhinieren e Arkitekturës, znj. Nafije Gashi, nuk janë ofruar dëshmi se e njëjta është e certifikuar për softuerin iSBEM-XK.

OE ankues "ALFA.I" SH.P.K. pretendon se AK-së konform nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së, ka mundur të kërkojë sqarime shtesë, për inxhinierin e kërkuar.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se kërkesë e dosjes së tenderit dhe e njoftimit për kontratë tek kërkesa nr. 16 është kërkuar: "OE duhet të paraqes se ka ne dispozicion Një Inxhinier i elektroteknikes te jete trajner për auditor te energjisë me standarde EN 16247 ose auditor i energjisë i certifikuar me standard EN 16247, te këtë provoj pune ne efiçencë te energjisë se paku 5 vite, gjithë ashtu edhe i certifikuar për softuerin iSBEM-XK ne vlerësimin e performancës se energjisë ne ndërtesa", si dëshmi dokumentare është kërkuar: "Diploma dhe certifikatat e noterizuar nga vete arkitekti nga origjinali, CV e nënshkruara nga inxhinieri, kontrata ose marrëveshja e punës për këtë projekt valide me punëdhënësin, titulli i projekti, vlera e projekti , vendimi i ekzekutimit të projektit".

Duke pasur parasysh kërkesën e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron për Inxhinier i elektroteknikes, të prezantuar në Listën e stafit Profesional, z. Petrit Krasniqi, në dosjen e tenderit nuk ka ofruar dëshmi fare.

OE ankues "ALFA.I" SH.P.K, pretendon se në dosjen e tenderit janë ofruar dokumentet gabim, pra janë ofruar dokumentet e Ramadan Gashit, dhe AK-së nuk i ka marrë parasysh fare sqarimet tona. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se kërkesë e dosjes së tenderit dhe e njoftimit për kontratë tek kërkesa nr. 18 është kërkuar: OE duhet të paraqes se ka ne dispozicion Një Inxhinier i makinerisë te jete trajner për auditor te energjisë me standarde EN 16247 ose Auditor i Energjisë i certifikuar me standard EN 16247, te këtë provoj pune menaxherja ne efiçencë te energjisë se paku 5 vite, gjithë ashtu edhe i certifikuar për softuerin i SBEM-XK në vlerësimin e performances se energjisë ne ndërtesa.

Duke pasur parasysh kërkesën e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se për Inxhinier i makinerisë, z. Sherif (Ramadan) Gashi, në dosjen e tenderit nuk ka ofruar dëshmi fare, mirëpo dëshmitë e ka ofruar të bashkangjitura me ankesë.

OE ankues "ALFA.I" SH.P.K. pretendon se nuk qëndron pretendimi i AK-së, se nuk janë plotësuar kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë sa i përket pikave 5, 6, 88, 12, 13 dhe 14, sepse siç shihet ka qenë i autorizuar nga ana jonë z.Lulzim Jahaj, që të bëjë Noterizimin e dokumenteve. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se kërkesë e dosjes së tenderit dhe e njoftimit për kontratë tek kërkesat me nr. 5 , 6, 8, 12, 13 dhe 14, është kërkuar që Diplomat dhe Certifikatat të Noterizohen nga vetë Inxhinierët dhe Ekspertët.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se pas analizimit të arsyes së eliminimit të AK-së, si dhe pas analizimit të dëshmive të ofruara nga OE ankues, rezulton se dokumentet e kërkuara si Diplomat apo

Certifikatat janë dërguar për noterizim tek Noteri nga z. Lulzim Jahaj, ashtu si e ka deklaruar edhe vet OE ankues.

OE ankues "ALFA.I" SH.P.K, pretendon se projekti në fjalë është tërhequr nga Kodi Ekonomik, është i pa bazuar. Paneli Shqyrtues konform eksperti shqyrtues sqaron se në e-prokurim nuk kamë mundur të hasë ndonjë dokument ku dëshmon se ky projekt është hekur nga Buxheti si Kod ekonomik. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se kërkesë e dosjes së tenderit dhe e njoftimit për kontratë për Inxhinierët e kërkuar tek pikët 15, 16 dhe 18, si dëshmi janë kërkuar që të njëjtit të jenë të certifikuar për softuerin i SBEM-XK në vlerësimin e performances se energjisë në ndërtesa. Andaj nga dëshmitë e ofruara nga OE ankues në dosjen e tenderit dhe dëshmitë e ofruara së bashku me ankesë, rezulton se znj. Nafie Gashi dhe z. Petrit Krasniqi, nuk kanë dëshmi se të njëjtit janë të certifikuar për softuerin SBEM-XK në vlerësimin e performances se energjisë në ndërtesa, për më tepër shih Certifikatën e z. Sherif Gashi.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, vlerëson se autoriteti kontraktues e ka anuluar këtë aktivitet të prokurimit në harmoni me nenin 62 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitë të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Blerim DINA

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK "Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit";

1x1 OE "Alfa.I"SH.P.K-Lipjan;

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.